



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 31/15

Prishtinë, më 30.09.2015, ora 11:00

ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Latif Gashi, Labinot Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bardhyl Meta.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave dhe Artan Venhari U.D Auditor të Përgjithshëm.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Fehlinger, Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami nga GIZ, Fjolla Uka –Monitoruese e KDI, Shefki Kastrati- NDI, Dukagjin Maliqi- gazetarë RTV Dukagjini, Blerta Gashi-Gazetarë nga Rrokum, Valmire Hoti- gazetarë nga Infodirekt, Sanije Isufi – gazetarë nga Kosovalive, Blerta Bejleri- PolAid,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua rendi i ditës si në vazhdim:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 16.09.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014;**
- 5. Shqyrtimi i Propozimeve të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - kam një propozim për ndryshimin e rendit të ditës. Në mungesë të sekretarit të Kuvendit që gjindet në udhëtim jashtë vendit, propozojë që pika e tretë të shtyhet për një mbledhje tjetër dhe në vend të kësaj të shtohet një pikë e re: Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim më

Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e normës së tatimit të akcizës.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet me ndryshime. Hiqet pika e tretë dhe në vend të saj shtohet pika e re e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e normës së tatimit të akcizës

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 16.09.2015

Kryetari – konstatoi se procesverbali i datës 16.9.2015 miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e normës së tatimit të akcizës

Kryetari - Qeveria ka marrë një Vendim me datë 25.9.2015, për vendosjen e normave të akcizës dhe sipas ligjit kërkohet konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, para hyrjes në fuqi të tij.

Avdullah Hoti – qeveria ka marrë vendim për rritjen e akcizës prej 0.10 cent në 0.15 cent për litër dhe këtë masë e kemi marrë që të barazojmë efektin e të hyrave buxhetore, pasi që po të njëjtën ditë e kemi miratuar në qeveri një udhëzim administrativ për heqjen e tatimit doganor prej 10%. Kjo edhe për faktin e përmbushjes së obligimeve ndaj Traktatit të Komitetit të Energjisë për lirim nga tatimi doganor të produkteve që importohen e që janë në fushën e teknologjisë dhe gazit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

P e r f u n d i m

Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/51 dt. 25.09.2015, për vendosjen e normës së tatimit të akcizës për “gazet e naftës dhe hidrokarburet tjera gazoike”, me shifër 2711, në vlerë prej 0.15 euro/l (pesëmbëdhjetë cent për një litër).

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Kryetari - ne bazë të nenit 3.2 dhe 6.1 të Ligji për themelimin e auditorit të përgjithshëm, auditori i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Kosovës. Normalisht ne presim se raporti i këtij institucioni të vije i kompletuar i detalizuar dhe në pajtim me buxhetin të cilin na e kemi aprovuar për vitin në fjalë.

Artan Venhari – pas kompletimit të auditimit të këtij institucioni ne kemi dalur me raport të cilin e kemi dorëzuar si të plotë në Kuvend. Opinioni i auditorit të jashtëm ka qenë i pakualifikuar, do të thotë se sipas vlerësimit të tyre pasqyrat tona financiare kanë qenë të besueshme dhe të prezantuara mirë. Unë konsideroj se Institucioni i Zyrës së Auditorit ka pas një performancë mjaftë të mirë gjatë vitit 2014. Sa i përket anës financiare ka pas disa ndryshime, mirëpo këto ndryshime janë të cilat i kanë përcjell të gjitha institucionet, si rritja prej 25% e pagave dhe pjesa tek mallrat e shërbimet që ka pasur zbritje. Si institucion nuk kemi pas tejkallime të asnjërës nga vijat buxhetore deri edhe pse jemi ballafaquar me një numër të sfidave, siç është edhe miratimi i Ligjit të ri për këtë institucion.

Kryetari – theksoi se në faqen 2 të raportit, te pjesa narrative ku flitet për paga dhe mëditje dhe për numrin e punëtorëve, është shkruar: se tek stafi menaxherial nuk është i përfshirë Auditori i Përgjithshëm dhe U.D. Drejtori i Përgjithshëm pasi që ende nuk janë pjesë e sistemit të liste-pagesave.

Ndërkaq në vazhdim thuhet se pagat për ta deri ne muajin shtator te vitit 2014 janë bashkfinancuar nga Qeveria e Suedisë dhe Buxheti i Kosovës dhe janë administruar nga Grupi Menaxhues Ndërkombëtar. Ndërsa në pjesën në vazhdim thuhet se që nga fillimi i shtatorit U.D. drejtor i Përgjithshëm është duke u paguar nga mallrat dhe shërbimet deri ne miratimin e ligjit te ri. Është një përzierje e çështjes që kërkon sqarim?

Artan Venhari – theksoi se pozita e auditorit të përgjithshëm dhe ushtruesit të detyrës se drejtorit të përgjithshëm sipas marrëveshjes ndërkombëtare janë paguar nga bashkësia ndërkombëtare dhe kjo marrëveshje në shtator të vitit 2014 dhe si pasojë ka skaduar pagesa për pozitën e auditorit të përgjithshëm. Ndërkaq pozita e drejtorit të përgjithshëm parashihet me ligjin e ri dhe në mungesë të aprovimit të ligjit është ushtrues detyre me kontratë mbi vepër deri me hyrjen në fuqi të ligjit.

Kryetari – po ashtu nga 147 pozita të lejuara me buxheti ju i keni punësuar 146, ndërsa buxheti në paga dhe mëditje është shpenzuar 100%. Si ka ndodhur kjo?

Artan Venhari - sqaroi se ne i kemi pasur të aprovuara 146 pozita dhe kjo mund të jetë ndonjë gabim teknik. Te stafi auditorë janë përfshirë 4 zëvendësuesit, që i kanë zëvendësuar auditorët që janë në pushim të lehonisë.

Kryetari – te stafi i auditorit i keni pas të lejuar 105 pozita ndërsa i keni rekrutuar 104, pra këtu është mungesa e një punëtori apo auditori.

Besa Gaxherri – theksoi se nuk është që nuk kemi besim për këtë institucion por është e papranueshme që të bëni gabime ju kur dihet se qëllimi i këtij institucioni është të raportojë për menaxhimin korrekt dhe të saktë të parasë publike. Prandaj kur flitet për ju ne kemi dëshirë me qenë gjithçka korrekte.

Artan Venhari - po e shoh se është gabim nga ana jonë por ne do ta rregullojmë këtë lëshim dhe deri nesër do t'iu dërgojmë sqarimet.

Kryetari - në parim e përkrahim raportin, por propozojë që të shtyhet miratimi i raportit, deri sa ZAP të sjell të dhënat dhe sqarimet për gabimet e evidentuara lidhur me numrin e punëtorëve dhe shpenzimet për paga dhe mëditje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

P ë r f u n d i m

- I. Raporti vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014, shtyhet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës.
- II. Kërkohet nga Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të sjell raport plotësues me të dhëna të sakta për numrin e të punësuarave dhe shpenzimet e buxhetit për kategorinë paga dhe mëditje për vitin 2014.

5. Shqyrtimi i Propozimeve të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së.

Kryetari – theksoi se në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore, është formuar Paneli seleksionues për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së dhe janë përzgjedhur pesë kandidatë për një pozitë. Shumica e kandidatëve janë propozuar disa herë dhe nuk janë votuar në Kuvend. Ndoshta ka nevojë me ndërhy në ligj për të përcaktuar kriteret për konkurrim. Sido që të jetë, ne propozojmë emrat në seancë plenare dhe atje të vendoset.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë një kandidatë për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim:

1. **Arben Dërmaku,**
2. **Hysen Ismajli,**
3. **Sejdi Rexhepi,**
4. **Bashkim Smakaj,** dhe
5. **Ramë Rexha.**

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

6. Të ndryshme

Kryetari – ne jemi në fazën kur duhet filluar të përgatitemi për buxhetin e vitit 2016. Unë kam biseduar me Organizatën që na mbështet GIZ, me qëllim të perfeksionimit të punës së komisionit apo specializimit në fushat e caktuara, anëtarët të jenë më të angazhuar dhe në këtë mënyrë të aplikojmë sistemin e raportueseve, që deputetët ti ngarkojmë me resore të caktuara. Unë kam menduar që Enver Hoti me qenë i caktuar në fushën e arsimit, Latif Gashi të angazhohet në fushën e punës dhe çështjeve sociale, Besa Gaxheri në fushën e Shëndetësisë nëse pranon. Raportuesit në punën e tyre do të mbështeten nga asistentët hulumtues që do të angazhohen nga GIZ

Bali Muharremaj – pranojë që të jetë i caktuar si raportues në fushën e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Fikrim Damka – pranoi që të jetë i caktuar si raportues në fushën e bujqësisë.

Latif Gashi - pavarësisht detyrave të reja unë mendoj se duhet me vazhdue me grupet punuese për buxhetin siç ka qenë.

Kryetari – sqaroi se qëllimi i raportueseve është që angazhohen më herët dhe të kemi informacione sa më shumë dhe mos të varem vetëm në ato që na thonë përfaqësuesit e organizatave buxhetore dhe me u specializue në sektor të caktuar, por ne gjithsesi do të punojmë në grupe punuese gjatë shqyrtimit të buxheti, që do të jenë tri grupe punues: për institucionet qendrore, lokale dhe institucionet e pavarura.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi caktimi e raportuesve për sektorët specifik:

Latif Gashi - raportues për sektorin e punës dhe çështjeve sociale,

Besa Gaxheri - raportuese në fushën e shëndetësisë (për tu konfirmuar)

Bali Muharremaj – raportues në sektorin e sigurisë,

Fikrim Damka – raportuese në fushën e bujqësisë,

Enver Hoti – raportues në fushën e arsimit (për tu konfirmuar).

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani

Pagatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit